



Republika e Kosovës * Republika Kosova * Republic of Kosova

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
Nezavisna Komisija za Rudnike i Minerale
Independent Commission for Mines and Minerals



Prishtinë, 25.02.2013

Në pajtim me nenin 51, nenin 59 paragrafi 1 dhe nenin 62 të Ligjit 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, Bordi i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale në mbledhjen e mbajtur më 18.01.2013 nxjerr këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV

(KPMM NR. 001/2013)

PËR SHTYRJET DHE PËRJASHTIMET E PAGESËS SË RENTËS MINERARE

Neni 1

Qëllimi

1.1. Me anë të këtij udhëzimi rregullohet dhe përcaktohet mënyra e pagesës së rentës minerare për të gjitha kompanitë të cilat posedojnë licenca për shfrytëzimin e mineraleve. Gjithashtu, me anë të këtij udhëzimi përcaktohen mekanizmat relevant brenda KPMM-së se si duhet të përpunohen të gjitha rastet me rastin e aplikimit nga çdo Bartës i Licencës për shfrytëzim për shtyrjet e obligimit, procedurën e përpunimit dhe afatin e shtyrjes së pagesës.

Neni 2

Kriteret dhe e drejta për hyrje në marrëveshje

2.1. Çdo Bartës i Licencës ka të drejtë të bëjë kërkesë për shtyrje të afatit të pagesave, përkatësisht programimit me këste të obligimeve për rente minerare.

2.2. Drejtori i KPMM-së mund të aprovoj shtyrjen e afatit dhe përjashtime sipas nenit 51 të Ligjit për Minierat dhe Mineralet.

2.3. Bartësi i Licencës për shfrytëzim mund të aplikojë në KPMM për një autorizim për shtyrjen e pagesës së një rente minerare, nëse para përfundimit të periudhës për të cilën duhet paguar rentën minerare, kufiri operativ i parave të gatshme është nën zero.

Rr. Armend Daci Nr.1
Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (38) 240 252
Fax: +381 (38) 245 844
E-mail: ICMM@kosovo-mining.org
Web: www.kosovo-mining.org

Kuvendi i Kosovës
Skupština Kosova
Assembly of Kosovo

Neni 3

Kërkesë për hyrje në marrëveshje

3.1. Bartësi i Licencës kur aplikon në KPMM për shtyrje të pagesës së rentës duhet që kërkesës t'i bashkangjes:

3.1.1. Pasqyrën e të ardhurave për vitin paraprak

3.1.2. Pasqyrën e të ardhurave me prerje në datën e aplikacionit për shtyrje të pagesës së obligimit ndaj rentës minerare

3.1.3. Gjendjen e të gjitha llogarive në emër të subjektit që aplikon për shtyrje të pagesës së obligimit ndaj rentës minerare

3.1.4. Pagesën e cila kërkohet sipas këtij udhëzimi

3.2. Komisioni mund të kërkoj një pagesë fillestare deri 30% të borxhit të tërësishëm si kusht për hyrje në marrëveshje.

3.3. Çdo kërkesë për shtyrje ose programim të borxhit duhet të shqyrtohet nga një komision ad-hoc (brenda Departamentit të Financave) i propozuar nga udhëheqësi i Departamentit të Financave i emëruar nga Drejtori i KPMM-së.

Neni 4

Afati i shtyrjes së rentës minerare

4.1. Bartësi i Licencës lidhur me rentën minerare ka të drejtë të hyjë në marrëveshje për obligimet të cilat i ka krijuar në periudhën TM3 dhe TM4 të vitit paraprak.

4.2. Bartësi i Licencës ka të drejtë të hyjë në marrëveshje edhe për obligimet që i krijon në vitin aktual.

4.3. Marrëveshjet zgjasin vetëm për atë vit kalendarik në të cilën hyhet në marrëveshje.

Neni 5

Aprovimi i kërkesës për hyrje në marrëveshje

5.1. Nëse Komisioni (komisioni i formuar brenda Departamentit të Financave) vendos se margjina e shpenzimeve të parave të gatshme e personit të pajisur me licencë është me të vërtetë më e vogël se zero në mbyllje të periudhës në fjalë, Komisioni mund të autorizojë shtyrjen e afatit të rentës në tërësi apo pjesërisht, në përputhje me nenin 51 të Ligjit për Minierat dhe Mineralet.

5.2. Nëse Komisioni vendos për shtyrje të afatit të pagesave, pra i lejohet programimi deri në fund të vitit kalendarik, atëherë subjekti duhet të paguaj dhe të sjell dëshminë e pagesës fillestare deri 30% të totalit të faturuar, varësisht nga vlerësimi i Komisionit.

5.3. Shuma e aprovuar e rentës së shtyrë do të akumulohet së bashku me të gjitha pagesat e tjera të mëparshme të rentës minerare.

5.4. Gjatë shqyrtimit të kërkesës, Komisioni mund të kërkoj dokumente shtesë dhe ta këshilloj kompaninë për kompletim të dokumenteve.

5.5. Komisioni vendos dhe përcakton edhe periudhën e shtyrjes së pagesës së rentës minerare në marrëveshjen e arritur.

5.6. Hyrja në programim të borxhit duhet të bëhet për secilin numër të faturës ose të regjistrimit në softuer për periudhën përkatëse dhe numër të licencës për të cilën kërkohet shtyrja e pagesës.

5.7. Paguesi i rentës minerare duhet të përmbush me rregull të gjitha detyrimet e tjera dhe t'i kryej ato krahas marrëveshjes së nënshkruar, përfshirë kryerjen me kohë dhe saktësi të pagesave të tremujoreve dhe pagesave tjera nëse janë të aplikueshme sipas kushteve të licencës dhe ligjit në fuqi.

5.8. Pas aprovimit të shtyrjes së afatit të pagesës, Departamenti i Financave do ta përgatis formën e pagesës dhe do ta regjistroj në softuerin e të hyrave.

Neni 6

Mos aprovimi i kërkesës për shtyrje të afatit të pagesës

6.1. Nëse Komisioni vendos se margjina e shpenzimeve të parave të gatshme e personit të pajisur me licencë është me e madhe se zero në mbyllje të periudhës në fjalë atëherë kërkesa për shtyrje refuzohet.

Neni 7

Njoftimi i kompanisë për vendimin

7.1. Nëse aprovohet kërkesa atëherë një shkresë e protokolluar së bashku me formën e pagesës së kësteve do t'i dërgohet Bartësit të Licencës brenda 2 ditë pune.

7.2. Nëse nuk aprovohet kërkesa Bartësi i Licencës njoftohet me shkrim duke përshkruar arsyet e mos aprovimit.

7.3. Nëse kërkohen dokumente shtesë, atëherë kompanisë mund t'i kërkohen ato përmes telefonit, postës elektronike ose njoftimit me shkrim.

Neni 8
Hyrja në fuqi

8.1. Ky udhëzim hynë në fuqi 8 ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ahmet Tmava
Kryesues i Bordit
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale